FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

RREGULLORE PËR SHPALLJEN E LAUREATËVE TË VITIT NË BASKETBOLL

Prishtinë, 06.11.2026

Federata e Basketbollit të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

PËRMBAJTJA:

NENI 1 – QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I RREGULLORES.....3

NENI 2 – LAUREATËT E VITIT NË BASKETBOLL 3

NENI 3 – KOMISIONI PËR SHPALLJEN E LAUREATËVE TË VITIT 4

NENI 4 – PROCEDURA 5

NENI 5 – KRITERET.....8

NENI 6 – KONFLIKTI I INTERESIT PËR ANËTARËT E KOMISIONIT.....10

NENI 7 – SHPËRBLIMI FINANCIAR.....11

NENI 8 – ZBATIMI DHE TRANSPARENCA.....11

NENI 9 – DISPOZITAT PËRFUNDIMATRE 11

SHTOJCA 1 – TABELA E POENTIMIT.....12

SHTOJCA 2 – PROCESI I SHPALLJES SË LAUREATËVE 13

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

Mbështetur në Nenin 24, paragrafi 1, alineja 1.27 të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i FBK-së më 06.11.2026 miraton këtë:

RREGULLORE PËR SHPALLJEN E LAUREATËVE TË VITIT NË BASKETBOLL

NENI 1 – QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I RREGULLORES

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është rregullimi i procedurës për shpalljen e laureatëve të vitit në basketboll, duke siguruar një proces gjithëpërfshirës, profesional, objektiv dhe transparent, në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe standardet institucionale të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK). Rregullorja synon forcimin e rolit profesional të trajnerëve dhe shoqatave përkatëse, reduktimin e subjektivitetit në procesin e propozimit dhe qartësimin e kompetencave të Komisionit dhe Bordit.

2. Gjithashtu Rregullorja përcakton llojet e çmimeve dhe shpërblimet për secilin çmim.

3. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga Federata e Basketbollit e Kosovës, klubet anëtare, trajnerët, shoqatat profesionale dhe organet përkatëse të FBK-së.

NENI 2 – LAUREATËT E VITIT NË BASKETBOLL

1. Federata e Basketbollit e Kosovës bën shpalljen e laureatëve të vitit në basketboll, përmes këtyre çmimeve:

- **1.1.** Basketbollisti i vitit;
- **1.2.** Basketbollistja e vitit;
- **1.3.** Top pesë (5) basketbollistët e vitit;
- **1.4.** Top pesë (5) basketbollistet e vitit;
- **1.5.** Skuadra më e mirë në konkurrencën e meshkujve;
- **1.6.** Skuadra më e mirë në konkurrencën e femrave;
- **1.7.** Trajneri më i mirë i vitit;
- **1.8.** Shpresa e vitit tek djemtë;
- **1.9.** Shpresa e vitit tek vajzat;
- **1.10.** Gjyqtari i vitit;

Federata e Basketbollit të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

1.11. Punëtori më i dalluar i vitit;
1.12. Ambasadori i basketbollit të Kosovës jashtë vendit;
1.13. Mirënjohje të tjera.

2. Vlerësimi për shpalljen e laureatëve bëhet mbi bazën e vitit kalendarik. Duke marrë parasysh strukturën e garave të basketbollit, viti kalendarik përfshin pjesë nga dy (2) edicione të ndryshme të kampionateve përkatëse. Në procesin e vlerësimit, merren në konsideratë rezultatet, performanca dhe kontributi i kandidatëve në të dy edicionet që bien brenda vitit kalendarik përkatës (cikli vlerësues).

NENI 3 – KOMISIONI PËR SHPALLJEN E LAUREATËVE TË VITIT

1. Bordi Ekzekutiv i Federatës së Basketbollit të Kosovës çdo vit emëron Komisionin për shpalljen e laureatëve të vitit në basketboll.

2. Komisioni përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, sipas kësaj përbërje:

2.1. Dy anëtarë të Bordit të FBK-së;
2.2. Një ish-basketbollist eminent vendor;
2.3. Një ish-basketbolliste eminente vendore;
2.4. Një gazetarë/e të sportit (preferohet nga fusha e basketbollit), të cilët i propozon Shoqata e Gazetarëve Sportiv të Kosovës.

3. Kryesues i Komisionit është një nga dy anëtarët e Bordit të FBK-së.

4. Komisioni vlerëson propozimet dhe i rekomandon Bordit listën përfundimtare.

5. Në mbledhjet e Komisionit merr pjesë edhe Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së, mirëpo, vetëm në cilësinë e këshillëdhënësit dhe pa të drejtë vote apo vendimmarrje.

Federata e Basketbollit të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

NENI 4 – PROCEDURA

LISTA E MBYLLUR E KANDIDATËVE

1. Për çmimet individuale:

1.1. Basketbollisti i Vitit;

1.2. Basketbollistja e Vitit;

1.3. Top 5 basketbollistët e Vitit;

1.4. Top 5 basketbollistet e Vitit;

1.5. Shpresa e Vitit (djem dhe vajza).

Federata e Basketbollit e Kosovës përgatit listën e mbyllur të kandidatëve për secilën kategori.

2. Lista e mbyllur përgatitet mbi bazën e kritereve objektive si në vijim:

2.1. kriteret e përgjithshme sipas nenit 5 të kësaj Rregullore;

2.2. statistikat zyrtare individuale, përkatësisht efikasiteti (indeksi) i kombinuar i edicioneve përkatëse;

2.3. rezultatet sportive në garat vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë rezultatet e arritura me Përfaqësuesen e Kosovës, të cilat kanë peshë të veçantë në vlerësim për shkak të rëndësisë kombëtare të përfaqësimit;

2.4. respektimin e kritereve etike dhe disiplinore.

3. Numri i kandidatëve në listën e mbyllur nuk mund të jetë:

3.1. më i madh se pesë (5) për çmimet Basketbollisti/ja i/e Vitit dhe Shpresa e Vitit (djem dhe vajza); dhe

3.2. më i vogël se pesë (5) dhe më i madh se dhjetë (10) për kategoritë Top 5 (me ç'rast votohen 4 lojtarë/e).

4. Lista e mbyllur ka karakter përfundimtar dhe shërben ekskluzivisht për qëllime votimi, pa të drejtë shtimi ose zëvendësimi të kandidatëve.

5. Trajnerët e ekipeve përkatëse marrin pjesë në proces vetëm përmes votimit nga lista e mbyllur e kandidatëve të përgatitur nga FBK, sipas procedurës të përcaktuar me këtë Rregullore.

Federata e Basketbollit të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

PËRGATITJA DHE SHPËRNDARJA E FORMULARËVE

6. Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) përgatit formularët zyrtarë për secilin çmim. Formularët shpërndahen si më poshtë:

6.1. Trajnerëve të ekipeve të Superligës së Meshkujve dhe Femrave për votim për çmimet: "Basketbollisti/ja e Vitit" dhe "Top 5 basketbollistët/et e vitit".

6.2. Trajnerëve të ekipeve të gjeneratave të reja për votim për çmimet: "Shpresa e Vitit" (djem dhe vajza).

6.3. Shoqatave profesionale përkatëse për propozimet: "Trajneri i Vitit" dhe "Gjyqtari i Vitit".

6.4. Klubeve anëtare për propozimet e çmimeve institucionale: "Skuadra e Vitit", "Punëtori më i dalluar", "Ambasadori i Basketbollit të Kosovës jashtë vendit" dhe mirënjohje të veçanta.

7. Trajnerëve u ndalohet të propozojnë lojtarë nga ekipi ose klubi i tyre gjatë sezoneve përkatëse.

MBUSHJA DHE DORËZIMI I FORMULARËVE

8. Subjektet e autorizuara plotësojnë formularët në mënyrë individuale, të pavarur dhe të paanshme, duke u bazuar vetëm në kriteret e përcaktuara.

9. Formularët e plotësuar dorëzohen pranë FBK brenda shtatë (7) ditëve nga data e dërgimit të tyre.

VOTIMI NGA TRAJNERËT

10. Trajnerët votojnë ekskluzivisht nga lista e mbyllur e kandidatëve, përmes formularëve zyrtarë të shpërndarë nga FBK.

11. Votimi bëhet në mënyrë individuale, të pavarur dhe të paanshme, pa të drejtë:

11.1. propozimi të kandidatëve të rinj;

11.2. ndryshimi të listës së mbyllur;

11.3. shënimeve jashtë formularëve zyrtarë.

12. Rezultatet e votimit për çmimet sportive individuale përllogariten automatikisht mbi bazën e formularëve të dorëzuar dhe përbëjnë bazën për shpalljen e fituesve.

Federata e Basketbollit të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

PROPOZIMET NGA SHOQATAT DHE KLUBET

13. Propozimet nga shoqatat profesionale dhe anëtare të FBK-së:

13.1. Trajneri i Vitit propozohet nga Shoqata e Trajnerëve të Basketbollit të Kosovës;

13.2. Gjyqtari i Vitit propozohet nga Shoqata e Gjyqtarëve të Basketbollit të Kosovës në koordinim me Instruktorin Nacional të FBK-së.

14. Propozimet nga Klubet:

14.1. Klubet propozojnë kandidatët për çmimet institucionale: Skuadra e Vitit, Punëtori i Vitit, Ambasadori dhe mirënjohjet e veçanta.

ROLI I KOMISIONIT PËR SHPALLJEN E LAUREATËVE

15. Komisioni mbledh të gjithë formularët e votimit dhe propozimet nga shoqatat dhe klubet.

16. Komisioni përmbledh dhe analizon rezultatet, shqyrton kriteret sportive, etike dhe profesionale dhe përgatit rekomandimin përfundimtar për Bordin e FBK-së.

17. Diskrecioni i Komisionit:

17.1. Për çmimet sportive individuale nga lista e mbyllur, Komisioni nuk ka të drejtë të ndryshojë, korrigjojë ose devijojë nga rezultati i dalë nga votimi, përveç rasteve kur konstatohet shkelje procedurale ose mos-përmbushje e kritereve sipas kësaj Rregullore, e dokumentuar dhe e arsyetuar me shkrim.

17.2. Për çmimet tjera, Komisioni ushtron diskrecion të plotë për vlerësim sipas kritereve të Rregullores.

VENDIMMARRJA NGA BORDI I FBK-SË

18. Pas shqyrtimit të rekomandimit të Komisionit, Bordi merr vendimin përfundimtar për shpalljen e laureatëve me shumicë votash.

19. Vendimi i Bordit dhe rekomandimi i Komisionit publikohen në faqen zyrtare të FBK-së dhe në mediat përkatëse, pas përfundimit të ceremonisë së shpalljes së laureatëve.

Federata e Basketbollit të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

CEREMONIA E SHPALLJES SË LAUREATËVE

20. Ceremonia zhvillohet çdo vit gjatë muajit Dhjetor, para Festave të Fundvitit.

21. Çdo informacion dhe dokumentacion i procesit të vlerësimit mbetet i regjistruar dhe i qasshëm për klubet dhe kandidatët, për të garantuar transparencë dhe përgjegjësi.

SHTOJCA 2 – PROCESI I SHPALLJES SË LAUREATËVE

Shtojca 2 i është bashkëngjitur kësaj Rregullore me qëllim thjeshtësimin dhe vizualizimin e procesit.

NENI 5 – KRITERET

1. Vlerësimi i kandidatëve bëhet mbi bazën e kritereve sportive, profesionale dhe etike, të cilat zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme për të gjitha kategoritë.

2. Kriteret e përgjithshme që duhet të përmbushen nga të gjithë laureatët e çmimeve në basketboll janë:

2.1. Basketbollisti/basketbollistja, shpresat, trajneri, gjyqtari, punëtori i dalluar sportiv etj. duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës.

2.2. Basketbollisti/basketbollistja që ka mbush moshën 12 vjeç deri në ditën që i mbushë 18 vjeç konsiderohet shpresë e basketbollit dhe i llogariten të gjitha rezultatet e arritura deri në ditën kur i mbush 18 vjeç.

2.3. Basketbollisti/basketbollistja, shpresat, trajneri, gjyqtari, punëtori i dalluar sportiv etj., përpos ambasadorit së basketbollit të Kosovës jashtë vendit, duhet të zhvillojnë aktivitetin me ekipet vendore (Kosovë) përgjatë dy edicioneve përkatëse (ciklit vlerësues).

2.4. Lojtarët me shtetësi të dyfishtë, të cilët luajnë si lojtarë vendorë në kampionatin e Kosovës dhe japin kontribut të rregullt në zhvillimin e tij, kanë të drejtë të jenë pjesë e listës së mbyllur, në përputhje me parimin e kontributit në basketbollin vendor.

Federata e Basketbollit të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

2.5. Pjesëmarrja dhe performanca me përfaqësuesen kombëtare mbetet element vlerësimi me peshë të rëndësishme, por jo kusht detyrues për të qenë pjesë e listës së mbyllur.

2.6. Çmimi "Trajneri i vitit" dhe "Gjyqtari i vitit" duhet të jenë nga kategoria më e lartë e veprimtarisë së tyre (p.sh. gjyqtarët nga Kategoria A).

2.7. Çmimi "Ambasadori i basketbollit të Kosovës jashtë vendit" i jepet një individi që, përmes kontributit të tij/saj në organizata apo gara ndërkombëtare dhe përfaqësimit profesional, ka ndihmuar në promovimin e imazhit të Kosovës dhe basketbollit të saj jashtë vendit.

2.8. Kandidatët për çmime duhet të kenë integritet profesional dhe disiplinor, përkatësisht të mos kenë qenë subjekt i masave disiplinore, etikës, integritetit të garave, dopingu apo sjellje që cenojnë reputacionin e Federatës së Basketbollit të Kosovës, gjatë periudhës së vlerësimit.

3. Për çmimet që shpallen mbi bazë të propozimeve, vlerësimi nga Komisioni bëhet në bazë të **kritereve për kategori të caktuara** si vijon:

3.1. Punëtori më i dalluar – kontributi në organizimin e ndeshjeve dhe aktiviteteve, bashkëpunimi me institucionet dhe Federatën, sjellja profesionale, angazhimi në promovimin e basketbollit në komunitet dhe mirëqenia sociale;

3.2. Trajneri i Vitit – rezultatet me ekipet, kontributi në zhvillimin sportiv të ekipeve, përgatitja teknike dhe taktike, bashkëpunimi me klubet dhe Federatën, sjellja profesionale, angazhimi në edukimin e lojtarëve dhe promovimi i basketbollit në komunitet;

3.3. Gjyqtari i Vitit – merren parasysh menaxhimi i ndeshjeve, njohja dhe zbatimi i rregullave të lojës, paanshmëria dhe sjellja profesionale, bashkëpunimi me klubet dhe Federatën, angazhimi në zhvillimin e gjyqtarëve të rinj dhe promovimin e integritetit në basketboll, posedimi i licencës FIBA, si dhe vlerësimi nga instruktori nacional dhe pasqyra e performancës gjatë periudhës përkatëse.

4. Përparësi do të ketë kandidati ose ekipi me rezultate më të mira në garat me nivel më të lartë (ndërkombëtare ose kombëtare), apo në rastin e individëve, kandidati që ka përfaqësuar Përfaqësuesen e Kosovës.

Federata e Basketbollit të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

5. Tabela e poentimit i është bashkëngjitur kësaj Rregullore në formë të Shtojcës. Poentimi i përcaktuar në *Shtojcën 1* shërben si instrument orientues për standardizimin e vlerësimit dhe për pasqyrimin e peshës relative të kritereve. Rekomandimi përfundimtar merret mbi bazën e vlerësimit profesional dhe kontekstual të Komisionit, në përputhje me kriteret e kësaj Rregulloreje.

NENI 6 – KONFLIKTI I INTERESIT PËR ANËTARËT E KOMISIONIT

1. Anëtarët e Komisionit kanë detyrë të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe profesionale gjatë gjithë procesit të vlerësimit.

2. Anëtarët e Komisionit nuk mund të marrin pjesë në vlerësimin ose diskutimin për kandidatët me të cilët kanë pasur gjatë vitit përkatës:

2.1. marrëdhënie kontraktuale (p.sh., lojtar/klub, trajner/klub, i/e punësuar/klub);

2.2. marrëdhënie profesionale të drejtpërdrejta (p.sh., asistencë sportive, trajnim, përfaqësim sportiv);

2.3. marrëdhënie financiare ose komerciale që mund të ndikojnë në objektivitet.

3. Anëtari që ka konflikt interesi duhet të njoftojë Komisionin dhe të hiqet nga çdo diskutim, poentim dhe vendimmarrje për kandidatin në fjalë.

4. Zëvendësimi i tij me një anëtar tjetër të Komisionit bëhet me miratimin nga Bordi Ekzekutiv.

5. Çdo situatë konflikti interesi duhet të dokumentohet në raportin përfundimtar të Komisionit, për të garantuar transparencë dhe përgjegjësi.

6. Kjo dispozitë siguron që vendimet për shpalljen e laureatëve të jenë të bazuara vetëm mbi kriteret objektive dhe profesionalizmin e Komisionit, duke shmangur çdo ndikim të jashtëm ose favorizim.

Federata e Basketbollit të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

NENI 7 – SHPËRBLIMI FINANCIAR

1. Çmimet vjetore për basketboll nga FBK shoqërohen edhe me shpërblim financiar.

2. Lartësinë e shpërblimit financiar për secilin çmim e përcakton Bordi i FBK-së për çdo vit.

NENI 8 – ZBATIMI DHE TRANSPARENCA

1. Komisioni për shpalljen e laureatëve është i detyruar të mbajë dokumentacion të detajuar për çdo vendim të marrë gjatë procesit të vlerësimit, përfshirë formularët e poentimit dhe vlerësimet individuale të secilit anëtar të Komisionit.

2. Pas përfundimit të ceremonisë së shpalljes së laureatëve, vendimi i Bordit të FBK-së së bashku me rekomandimin e Komisionit do të publikohen në faqen zyrtare të Federatës dhe në mediat përkatëse.

3. Çdo klub ose kandidat ka të drejtë të kërkojë informacion të detajuar mbi mënyrën se si janë marrë vendimet dhe të kërkojë shpjegime për vendimet përfundimtare.

NENI 9 – DISPOZITAT PËRFUNDIMATRE

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i FBK-së.

2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje i propozon Sekretari i Përgjithshëm, të cilat i miraton Bordi i FBK-së.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben **FETAHU**
Kryetar

Federata e Basketbollit të Kosovës
Prishtinë, 06.11.2026

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO
FBK
PRISTINA
PRIŠTINA
PRISHTINË

Federata e Basketbollit të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

SHTOJCA 1 – TABELA E POENTIMIT

Çmimi	Kriteret	Pikët
Skuadra e vitit	Rezultatet në gara ndërkombëtare të njohura nga FIBA, renditja në Top 16-she ose më lart	30
	Kampion i Kosovës	30
	Fitues i Kupës së Kosovës	15
	Fitues i Superkupës	10
	Zhvillimi dhe investimi në lojtarët e rinj	10
	Organizimi i ekipit dhe angazhimi në komunitet	5
Trajneri i vitit	Rezultatet sportive të skuadrës (në garat vendore dhe me Përfaqësueset e Kosovës)	50
	Zhvillimi i lojtarëve	30
	Lidershipi, sjellja profesionale dhe motivimi	20
Gjyqtari i vitit	Performanca në gara kombëtare & ndërkombëtare	50
	Numri i ndeshjeve të drejtuara në nivel kombëtar	20
	Aftësitë për menaxhimin e ndeshjeve të vështira (sipas raportit nga Instruktori Nacional)	20
	Etika dhe sjellja profesionale	10
Punëtori më i dalluar i vitit	Kontributi për organizimin e aktiviteteve të basketbollit	40
	Inovacionet për zhvillimin e infrastrukturës ose aktiviteteve sportive	20
	Përkushtimi ndaj zhvillimit të basketbollit për të rinjtë	20
	Angazhimi në promovimin e basketbollit në komunitet	10
	Sjellja profesionale dhe ndershmëria	10
Ambasadori i Basketbollit të Kosovës jashtë vendit	Performanca apo puna në kampionatet/organizatat e huaja	50
	Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i Kosovës	30
	Sjellja profesionale, përfaqësimi i denjë i Kosovës në vendin e huaj	20

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

SHTOJCA 2 – PROCESI I SHPALLJES SË LAUREATËVE

